

## Si mund t'ju ndihmojë Organizata humanitare ekumenike?

Të kthyerëve sipas marrëveshjes për ripranim, në mes të tjerash, u ofrojmë:

- këshilla juridike dhe informata rreth mundësisë së punësimit dhe nisjes së bizneseve personale,
- marrjen e dokumenteve të nevojshme, me përkthim nga ana e përkthyesit të autorizuar gjyqësor
- organizimin e trajnimeve për kërkim aktiv të punës dhe përpilimin e planeve për biznes
- ndihmë për nisjen e bizneseve të vogla

**Na kontaktoni!**

Organizata  
humanitare  
ekumenike  
Novi Sad,  
Cirila dhe Metodija 21  
pravnorrc@ehons.org  
+ 381 (0)21 674 99 41  
+ 381 (0)21 639 76 26  
<http://romacenter.ehons.org>  
<http://www.ehons.org>

*Publikimi është botuar në kuadër të Programit „Të kthyerit sipas marrëveshjes për ripranim dhe rrjedhat e migrimit“, të cilin financiarisht e ka mbështetur Komisarijati për refugjatë dhe migrime, ndërsa e zbaton Organizata e përgjithshme humanitare. Përmbajtja e publikimit paraqet përgjegjësi vetëm për Organizatën humanitare ekumenike dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Komisarijatit për refugjatë dhe migrime.*



Ekumenska  
Humanitarna  
Organizacija



КОМИСАРИЈАТ  
ЗА ИЗБОШТАЊЕ И МИГРАЦИЈЕ  
РЕПУБЛИКЕ СРБИЈЕ

Programin e ka financuar  
Komisarijati për refugjatë  
dhe migrime, ndërsa  
është duke e realizuar  
Organizata e përgjithshme  
humanitare.



# PUNËSIMI I TË KTHYERËVE SIPAS MARRËVESHJES PËR RIPRANIM

Shumë njerëz, me kthimin e tyre në Sërbë, ballafaqohen me mungesë të punës. Papunësia e gjatë rrezikon pozitën ekonomike dhe sociale të individëve dhe familjeve të tyre.

Në qoftë se jeni të papunësuar, që t'i realizoni të drejtat e juaja **është e rëndësishme që të lajmëroheni në Shërbimin nacional për punësim** në vendbanimin tuaj. Nëse keni mes 15 dhe 65 vjet dhe jeni të aftë për punë, Shërbimit nacional për punësim duhet t'ia dorëzoni këto dokumente:

- **letërnjoftimin**
- **librezën e punës**
- **diplomën**

(dëshminë, vërtetimin) për nivelin e mbaruar të arsimit ose pa diplomë nëse jeni person i pakualifikuar

**Librezën e punës** do ta merrni ashtu që në Drejtoratin për administratë të përgjithshme në komunën ku jetoni do të dorëzoni këto dokumente:

- kërkesat e plotësuara dhe librezën e punës të paplotësuar (e që mund ta bleni në komunë apo në librari),
- letërnjoftimin
- vërtetimin mbi shtetësinë
- diplomën për nivelin e mbaruar të arsimit (shkollimit)

Në rast se shkollën fillore apo atë të mesme e keni mbaruar jashtë vendit ku jetoni, **dokumentet e tilla shkollore duhet t'i nostrifikoni**. Nëse jetoni në KA të Vojvodinës, nostrifikimin mund ta bëni në Sekretariatën krahinor për arsim (Novi Sad, Bulevardi Mihajlo Pupin 16).

Çfarë **përfitimesh** ofron paraqitja në Shërbimin nacional për punësim? Disa nga ato janë:

- krijimi i masave dhe aktivitetëve që do t'ju mundësojnë në kërkimin aktiv të punës
- informimi dhe këshillimi profesional
- arritja e njohurive praktike
- marrja pjesë në panairët për punësim
- trajnimet dhe perkrahja financiare për fillimin e bizneseve tuaja personale
- programe speciale për personat në nevojë dhe për ata që vështirë mund të punësohen

Paraqitja në Shërbimin nacional është e rëndësishme edhe nëse jeni socialisht të rrezikuar, sepse për shumë forma **të mbrojtjes sociale** (si p.sh. shtesat e fëmijëve apo ndihma sociale) kërkohet vërtetimi i cili dëshmon që jeni të evidentuar si person i papunësuar.

Kur të lajmëroheni në evidentimin e Shërbimit nacional për punësim, është e rëndësishme që rregullisht të lajmëroheni sipas dinamikës të cilën ata jua tregojnë dhe të merrni pjesë në masat për kërkimin aktiv të punës. Nëse pa arsye të justifikuar nuk i kryeni obligimet e juaja ndaj Shërbimit nacional mund të fshiheni prej listës së evidencës!